



07/15

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA KOMUNA-
MALISHEVË/DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE NË MALISHEVË**

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, të nenit 8 të Ligjit të Punës nr: 03/L-212, në bazë të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017. Në bazë të Udhëzimit Administrativ Për Kujdesin Parësor Shëndetësor Nr. 04/2020, nenit 15, si dhe në bazë të njoftimit të Masës Monetare të dt: 24.01.2023 të Zyrës për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës – DSHMS Malishevë shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS.

Titulli i vendit të punës: Mjek/e i/ e Përgjithshëm/e në QKMF-“Dr: Shpëtim Robaj”- Malishevë.

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave	(9) Nëntë.
Titulli i mbikëqyrësit	Drejtori i QKMF-së
Grada/ Koeficienti	7.2- H 27
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë pacaktuar
Periudha Provuere	Gjashtë (6) muaj

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik

Detyrat dhe përgjegjësitë për mjek/e i/e përgjithshëm

- Ofron shërbime me standardë të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi.
- Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për pacientin nën mbikëqyrjen e mjekut familjar.
- Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikëqyrjen e Mjekut Familjar.
- Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë
- Kujdesi për personat në nevojë
- Mbanë kujdestari gjatë vikendit dhe natën.
- Mbanë orarin prej 40 orë në javë sipas Ligjit Për Zyrtarët Publik dhe Ligjit të Punës.
- Edukimi shëndetësor etj.

Dokumentet e nevojshme:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë drejtimi i përgjithshëm (kopjen e noterizuar)
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuar nga MASHT:
- Formulari i aplikimit i plotësuar:
- Rezymeja personale (CV):
- Licencën e punës me afat, (kopjen e noterizuar):
- Certifikatën e lindjes: (Originalin)
- Certifikatën që nuk është nën hetime ose i dënuar në Gjykatë (Originalin).
- Letërnjoftimin e fotokopjuar:
- Certifikatën e mjekut për punë (Pas përzgjedhjes nga Komisioni):
- Përvoja e punës (e dëshirueshme).

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe të noterizuara, siç janë të renditura më lartë.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë.

Aplikacionet dorëzohen nga data 27.02.2023 deri me dt: 13.03.2023. Aplikacionet merren dhe dorëzohen ne Zyrën e Personelit ne QKMF (ditëve të punës prej: 07 deri ora 15).

- Konkursi shpallet në linkun: <http://konkursi.rks-gov.net> si dhe në tabelën e shpalljeve ne KK-Malishevë dhe në QKMF. Të gjitha njoftimet e tjera dhe shpalljet vendosen në tabelën e shpalljeve në QKMF.

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Malishevë.
27.01.2023



DREKTORI I DSHMS-së

Hajdin Berisha